



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

**LEGJISLATURA V**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 9.8.2016, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Emilija Rexhepi, Sërgjan Popoviq, Salih Salihu.

Munguan: Haxhi Shala dhe Shaip Muja.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13.7.2016;
3. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror ;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

**1. Miratimi i rendit të ditës ;**

Rendi i ditës për këtë mbledhje, u miratua pa vërejtje.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13.7.2016;**

Procesverbali i datës 13.7.2016, u miratua pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror;**

**Kryesuesja**, për këtë pikë të rendit të ditës, sugjeroi vazhdimin e punës së Komisionit në 6- mujorin vijues sipas planit të punës dhe agjendës legislative, mirëpo, me vërejtje për Qeverinë që projektligjet (nga 18 sa janë sugjeruar nga Qeveria) sipas agjendës së miratuar ende nuk janë dërguar në Kuvend, përveç dy nga MMPH-ja, andaj Komisioni kërkoi që Qeveria të njoftohet lidhur me këtë ngase si pasojë kemi mosangazhimin e duhur të Komisionit në fushat e veprimtarisë së sajë. Ajo njëherësh propozoi disa vizita shitesë lidhur me çështjen e ujërave dhe ujësjellësit si brenda ashtu edhe jashtë vendit, fillimisht në rajonin e Prizrenit e pastaj edhe në Zvicër, me ndihmën e ambasadës në Prishtinë përmes koordinatorit në Qeverinë e Kosovës z. Baton Begolli, i cili do të kontaktohet nga stafi lidhur me mundësinë e takimit të kryesueses dhe dy anëtarëve të Komisionit me zyrtarët e ambasadës së Zvicrës.

**Murat Hoxha** insistoi që vizita në Shqipëri të përgatitet sipas rregullave që vlejné në Kuvend, së pari të njoftohet Kryesia, mirëpo, stafi sqaroi se kryesia njoftohet me shkresë në atë moment kur konfirmohet vizita nga nikoqirët nga Shqipëria, njëherësh kërkohet mbulesa financiare nga Kuvendi, ashtu si janë kryer deri tani çdo vizitë e Komisionit apo vizitë individuale e deputetëve ose kryetarit të komisionit, prandaj edhe njëherë u konfirmua që kjo shkresë të bëhet posa të krijohen kushtet formale, pas pushimeve verore gjatë muajit shtator, ku do të sugjerohet edhe agjenda e takimeve me komisionin homolog dhe dy ministri të fushës.

**Adem Salihaj**, më pas sqaroi kërkesën e kryesueses, e cila fajësoi Qeverinë për mosangazhimin e këtij Komisioni për shkak të mosdërgimit të projektligjeve dhe u pajtua që ky njoftim t'u dërgohet dy ministrive të fushës së komisionit, MB-ja nuk ka dërguar asnjë Projektligj nga 9, sa është zotuar, ndërsa MMPH-ja ka dërguar vetëm dy nga 9, sa ka pasur me i dërgua për agjendën e këtij viti të Kuvendit. Salihaj potencoi edhe Projektligjin për Zhurmën, i cili tha se duhet të kryhet deri në fund të shtatorit.

Kryesuesja Rexhepi reagoi se Komisioni është pajtuar për një pushim deri shtator në lidhje me këtë projekt dhe premtoi se ai do të kryhet, kurse në fund Salihaj, tha se mbikëqyrja e dy ligjeve me siguri do të në shtator dhe propozoi formimin e Grupit të Punës për Performancën Energjetike, ndërkaq u vendos që Grupin e Punës për këtë projektligj do të kryesojë **Duda Balje**, me anëtarët : **Salih Salihu, Murat Hoxha dhe Sërgjan Popoviq.**

#### **4. Të ndryshme.**

**Kryesuesja**, në këtë pikë njoftoi Komisionin se gjatë javës që vjen, do të njoftohet për mundësinë e mbajtjes edhe të një mbledhjeje të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,  
**Duda Balje**